VENDIM
Nr. 13, datë 3.3.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR Nr. 431, datë 11.11.2021, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR"

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 3.3.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 431, datë 11.11.2021, 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Shkodër'",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Shkodër (UK Shkodër), me shkresën nr. 328 prot., datë 21.2.2023, me lëndë: "Kërkesë për ndryshimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Shkodër për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.
3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Shkodër me vendimin nr. 431, datë 11.11.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Shkodër, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Shkodër sh.a., z. Arvit Bushati, ka përfunduar master shkencor në "Drejtësi civile dhe tregtare".
5. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Shkodër sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Shkodër është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 2 të vendimit të KKRR-së nr. nr. 431, datë 11.11.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Shkodër", bëhen këto ndryshime:

"Drejtues ligjor: z. Arvit Bushati."
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani